

BANESA ‘KALIVE’ E VLEHËVE / THE VLACH’S DWELLING ‘KALIVE’

Vllehët, të njohur mes tyre si *Arāmān/Rāmān*, janë një grup etnolinguistik që historikisht ka jetuar në territoret e Ballkanit. Tipar dallues i këtij komuniteti është gjuha, një dialekt me prejardhje nga latinishtja, si edhe mënyra e jetesës, e bazuar kryesisht në blegtorinë shtegtare.

Vllehët përmenden për herë të parë në burimet bizantine të shekullit të 11-të, në zonën malore të Thesalisë, të njohur si Vllahia, dhe në vazhdim në Epir, Maqedoni, e më gjerë.

Lugina e sipërme e Vjosës ka shërbyer si një nga rrugët e kalimit gjatë lëvizjeve sezonale të vllehëve, nga kullotat dimërore në bregdetin jonian për në kullotat verore në malin e Gramozit.

Në udhëtimin që zgjaste rreth dhjetë ditë, vllehët lëviznin familjarisht, dhe ndiqeshin nga kope të mëdha bagëtish të imëta. Përgjatë rrugës, ata ngrinin kampet ditore, me tenda prej leshi, ndërkohë që gjatë qëndrimit në kullotat verore, ndërtonin kampet e përkohshme, me banesa të njohura si ‘kalive’. Ato ishin struktura rrethore, të ndërtuara me shkopinj druri dhe çati të mbuluar me kashtë. Muret dhe dyshemeja visheshin me baltë. Në brendësi vendosej vatra dhe rafte prej druri.

Gjatë Mesjetës, grupe vllehësh u vendosën në fshatrat malorë në lindje të luginës së sipërme të Vjosës, duke humbur aspektin nomad të jetesës, por jo gjuhën e tyre. Të tjerë vazhduan ende të shtegtonin, deri në vitet 1950, kur shteti shqiptar i ndaloi lëvizjet e vllehëve, dhe disa familje prej tyre u vendosën përfundimisht në fshatrat e luginës.



Familje vllehësh gjatë shtegtimit për në kullotat verore
Vlach family on the way to summer pastures


The Vlachs, are known to themselves as *Arāmān/Rāmān*. They are an ethnolinguistic group that have historically inhabited swathes of the Balkans territory. They are distinguished by their language, which is a dialect derived from Latin, and by their way of living, based primarily on pastoral transhumance.

The Vlachs are initially mentioned in Byzantine sources of the 11th century, occupying the mountain areas of Thessaly, known as Vlachia, and subsequently in the territories of Epirus, Macedonia and beyond.

The Upper Vjosa valley was one of the main routes used during Vlachs seasonal movements from winter pastures in the Ionian coast, towards the summer pastures in the Mount Gramos.

The whole journey would last around ten days, and Vlachs families were followed by substantial herds of sheep. Daily camps of simple woolen tents were set up on their treks. Once arrived in the summer pastures, the Vlachs build their yearly encampment, consisting of several familiar dwellings, known as ‘kalive’. These were circular structures made of wood and covered with thatched roofs. Walls and floors were mud-plastered, and the interior consisted of a simple hearth and wooden shelves.

During the Medieval era, Vlach families began to permanently settle in the mountain areas to the east of the Upper Vjosa valley, ultimately losing their nomadic aspect of life, but not their language. Other Vlachs continued to travel until 1950, when the Albanian state banned Vlach transhumance, and several families were settled in villages of the valley.



Kamp veror me ‘kalive’ / Summer encampment with ‘kalive’



Kamp ditor me tenda / Daily camp with tents



Nëpërmjet smartphone-it tuaj ndiqni ‘rrugën e vllehëve’ nga qafa e Dhëmbelit në malin e Gramozit
Through your smartphone, follow the ‘Vlach’s route’ from Mt. Dhëmbeli pass to Mt. Gramos.



Vizitoni faqen web të projektit INCULTUM
Visit INCULTUM webpage



Projekti INCULTUM, financuar nga programi H2020, i Bashkimit Europian. / INCULTUM project, financed by H2020 programme of the European Union.